Komiteti për Arsim i Kuvendit të Komunës së Deçanit pas vizitave të kryera në gjashtë shkolla amë dhe në një paralele të ndarë fizike, si dhe pas debatit të zhvilluar në Tryezën e rrumbullakët me temën: " Gjendja dhe kushtet në të cilat zhvillohet procesi Edukativo – Arsimor në disa prej shkollave të Komunës së Deçanit, të mbajtur më 19.11.2014, Komiteti për Arsim në takimin e mbajtur më 05.12.2014, nxjerrë rekomandimet e veta dhe i propozon Kuvendit të Komunës së Deçanit që në mbledhjen dt.30.01.20154, të miratoi këto:

REKOMANDIME

1. I rekomandojmë Kryetarit të Komunës, që në mbështetje të obligimeve dhe përgjegjësive të tij, të themelojë një mekanizëm të përkohshëm të përbërë nga ekspert të fushës së arsimit dhe nga segmentet e tjera, të cilët pas një analize dhe studimi të gjithanshëm, të hartojë një strategji të funksionimit të Shkollave të Komunës se Deçanit të bazuar në trendët e rënies sistematike të numrit të nxënësve. Në këtë dokument do të specifikoheshin çartë objektivat dhe orientimet të cilat hapin rrugë për një stabilitet të plotë të funksionimit të arsimit sipas standardeve të parapara me ligj.
- Cilat do të ishin shkollat që do të duhej të rrënoheshin për shkaqe të vjetërsisë ose eventualisht arsyeve të tjera.
- Kur parashihet që ato të zëvendësohen me objekte të reja? Cili është plani dinamik për këtë?
- A do të ketë në parashikimet afatmesme e afatgjata shkolla të cilat do të detyrohen të mbyllen për shkak të numrit të nxënësve në rënie?
- Si do të normalizohen normat që ato të jenë në përputhje me numrin e nxënësve nëpër shkolla dhe si do të tejkalohet kjo problematikë e krijuar pa u dëmtuar personeli i shkollave, nxënësit dhe komunitetet? Këto do të ishin fushat në të cilat do të përqendrohej puna e këtij mekanizmi. Afati i përfundimit të punës, Qershor 2015.

2. I rekomandojmë Inspeksionit sanitar të Komunës së Deçanit që deri më 28 Shkurt 2015, t'u bëj vizitë të gjitha shkollave të Komunës së Deçanit dhe të hartojë raport për gjendjen higjienike në shkolla si dhe të marrë masa preventive në përputhje me konstatimin e gjendjes.

3. Presim që Drejtoria e Arsimit në Deçan të kërkojë nga përfaqesuesit e KEDS-it në Deçan që urgjentisht të dërgojë ekipet në SHFMU " Lan Selimi ", në Lumbardh dhe paralelen e ndarë në Llukë të Ulët, që të eliminojnë përfundimisht të gjitha problemet me energjinë që i kemi konstatuar.

4. U rekomandojnë të gjitha shkollave që janë objekt i këtyre rekomandimeve, përveç SHFMU " Sylë Alaj " në Drenoc, që të përpilojnë listat me titujt e lektyrave të domosdoshme shtëpiake nga klasa e I-rë deri në klasën IX-të me numër të ekzemplarëve për secilin titull dhe një kopje t'i dorëzojnë DKA-së në Deçan, kurse një kopje tjetër në Komitetin për Arsim. Afati i dorëzimit, deri më 12 Shkurt 2015.

5. I rekomandojmë DKA-së në Deçan dhe Zyrës së Prokurorimit, që të marr të gjitha masat që të gjitha shkollat të cilat nuk e posedojnë sistemin e ngrohjes qendrore, të furnizohen me lëndë djegëse më së largu deri në gjysmën e parë te muajit Shtator 2015.

6. I rekomandojmë Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Buxhetit dhe Zyrës së Prokurorimit që sipas nevojës në bashkërendim edhe me mekanizma të tjerë, që më së largu deri në Maj të vitit 2015, të ndërhyjnë në përputhje me shkallën e dëmtimit në çatinë e SHFMU: " Esat Mekuli " në Maznikë, dhe në objektin e paraleles së ndarë fizike në Dubovikë.

7. Sipas vlerësimeve të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Inspeksionit sanitar deri në fillim të vitit shkollor 2015/16 është e domosdoshme të ndërhyhet në nyjet sanitare të të gjitha shkollave dhe në kanalizimet e tyre që ato përfundimisht të bëhen funksionale dhe sipas standardeve të pranueshme. Poashtu Ekzekutivi komunal duhet t'u sigurojë gjeneratorë të gjitha shkollave të cilat furnizohen me ujë nga puset.

8. Nëse Komuna nuk ka ndonjë plan tjetër rreth objektit të vjetër të SHFMU " Lan Selimi " në Lumbardh dhe atij të SHFMU " Faik Konica " në Ratishë, deri në fillim të vitit shkollor 2015/16 të hiqen dërrasat nga dyshemetë e këtyre shkollave si dhe tavanet e kësaj pjese më SHFMU " Faik Konica " të zëvendësohen me materie adekuate.

9. Komuna duhet që urgjentisht të gjej zgjidhje për kanalin e ujit që kalon përmes oborrit të pjesës së vjetër të shkollës " Lan Selimi " në Lumbardh, kurse drejtorit të kësaj shkolle i rekomandojmë që në bashkëpunim me komunitetin të merr masa preventive për vendosjen e mbrojtëseve në hyrje të kësaj pjese të objektit në mënyrë që të mos e pësojnë nxënësit dhe personeli. Poashtu rekomandojmë që në SHFMU " Sylë Alaj " në Dranoc si dhe në SHFMU " Esat Mekuli " në Maznik të ndërtohen hapësira për deponimin e druve për ngrohje.

10. Komiteti për Arsim kërkon që Ekzekutivi komunal të ndërhyj tek kompania përkatëse që të vazhdojë punimet në Sallën e Ed.fizike në SHFMU " Avni Rrustemi " në Irzniq.

11. Kërkojmë nga Drejtoria e Arsimit që në bashkëpunim me MASHT-in dhe MKRS-në të gjej zgjidhje për inventarizimin dhe rregullimin e terreneve sportive sipas kërkesave të drejtorëve të shkollave përkatëse.

12. Kërkojmë nga Ekzekutivi komunal që të ndërhyj në përmbushjen e obligimeve të kontratës që i takojnë kompanisë përkatëse për lidhjen e rrymës dhe të nyjeve sanitare të SHFMU "Rexhep Kadrijaj" në Rastavicë. Siç dihet objekti i ri ende nuk është lëshuar në përdorim për këto arsye.

13. Kërkojmë nga Drejtoria Komunale për Arsim që në bashkëpunim me Drejtorët e Shkollave të angazhohet për ngritje të cilësisë në arsim.

Me nga një kopje të këtyre Rekomandimeve do të paisen: Kryetari i Komunës, Drejtoria Komunale për Arsim, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Inspekcione dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapsinorë.

Deçan,dt.30.01.2015

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

HYRESE-ULAZNA-INGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT • OPŠTINA DEČANE • DEÇANI MUNICIPALITY
Nga: Od: From: KK- Deçan
Nr Prot: Br. Prot: Prot. No. 2413
Nr. I faqeve: Br. Strajnica: No. Pages 01
Data: Date: Date 03-02-15
DEÇAN DEČANE

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA • KOMUNA E DEÇANIT • OPŠTINA DEČANE • DEÇANI MUNICIPALITY • Komunal • Skupština Opštine • Assembly • Kuvendi

Kryesuesi i Kuvendit:
Jashar Dobraj